

MOS HESHT!

Bëj diçka,
NDAL trafikimin
me njerëz!

0800 11 112 ose 192
Broshurë Informative



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Shfrytëzimi seksual i viktimave të trafikimit është krim dhe do të ndëshkohesh për veprimin tënd!

Mos iu jepni para fëmijëve në rrugë!
– Ata kanë nevojë për edukim, jo për lëshohërkim!

Së bashku mund ta ndalojmë trafikimin me njerëz.

Vepra drejt! Raporto shfrytëzimin!

antitrafikimi@kosovopolice.com

Dyshoni në diçka? A jeni Viktimë? Nëse dyshoni se një fëmijë ose i rritur është duke u blerë, shitur apo shfrytëzuar, ju lutemi telefononi në linjën ndihmëse:

0800 11 112 ose 192

MOS HESHT!

PARANDALO TRAFIKIMIN ME NJEREZ!



Ofruesit e kujdesit shëndetësor mund të vijnë në kontakt me viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të kenë një mundësi unike për t'i referuar ato tek zyrtarët përgjegjës për të vazhduar me marrjen e shërbimeve të tjera të nevojshme.

Çdo person në një mjedis të kujdesit shëndetësor, mund të jetë në gjendje të identifikoj një viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore - nga stafi mirëmbajtjes, tek teknikët e laboratorit, personeli infermieror, kujdesi ambulantor, personeli i sigurisë e në fund mjeket gjatë ekzaminimit të tyre shëndetësor.

PARIMET UDHËHEQËSE SPECIFIKE PËR PUNONJËSIT SHËNDËTËSOR:



- Trajto çdo kontakt me personat e trafikuar si një hap drejt përmirësimit të shëndetit të tyre;
- Jepi prioritet sigurisë së personave të trafikuar, vetes dhe stafit;
- Ofro kujdes ne respekt, barazi dhe pa diskriminim;
- Përgatit informacione referimi dhe detaje të kontaktit të njerëzve të besuar;
- Bashkëpunoj me ofruesit e tjerë të shërbimit;
- Jep informacione në një gjuhë që personi e kupton;
- Respekto të drejtat, zgjedhjet dhe dinjitetin e çdo individi;
- Mbjaj informacionin mbi personin e trafikuar në një vend të sigurt.

Treguesit e mundshëm që ofruesit mjekësorë mund të shohin tek një pacient i cili mund të jetë viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore mund të jenë tregues të përgjithshëm, tregues fizik, treguesit e shëndetit mendor dhe treguesit seksual.

TREGUESIT E PËRGJITHSHËM TË TRAFIKIMIT ME NJERËZ

- Nuk dëshiron ose heziton t'u përgjigjet pyetjeve në lidhje me dëmtimin ose sëmundjen
- Shoqërohet nga një individ i cili nuk e lejon pacientin të flasë vetë;
- Demonstron sjellje të frikshme ose shmang kontaktin me sy;
- Nuk është në gjendje të japë adresën e tij/saj;
- Nuk është në dijeni të vendndodhjes së tij/saj, datës aktuale ose orës;
- Nuk posedon dokumentet e tij/saj të identifikimit;
- Nuk ka kontroll mbi paratë e tij ose të saj;

TREGUESIT E SHËNDETIT FIZIK

- Shenja të abuzimit fizik ose lëndime të pashpjegueshme, mavijosje, djegie, prerje ose plagë;
- Trauma e forcës së hapur, thyerje, dhëmbët e thyer, shenjat të torturës;
- Dhimbje koke ose migrenë, humbje e pashpjegueshme e kujtesës, pagjumësi, vështirësi në përqendrim;
- Aritmi, presioni i lartë i gjakut, shqetësime akute të frymëmarrjes;
- Çështje të shëndetit dietik, humbje e rëndë në peshë, kequshqyerja dhe humbje e oreksit.

TREGUESIT E SHËNDETIT MENDOR

- Depresion, ideja e vetëvrasjes, sjellje vetë-dëmtuese;
- Ankth, çrregullimi i stresit post-traumatik, makthet, mungesa e reagimit emocional;
- Ndjenja turpi ose faji, hipër-vigjilencë, armiçësi, të ndjerit konfuz dhe pa shpresë;
- Shenjat e tërheqjes, frikës, trishtimit, ose nervozizëm, ndjehen si vëzhgues të jashtëm të vetvetes, sikur shikonin veten në një film;
- Mpirje emocionale ose fizike të shqisave.

TREGUESIT SEKSUAL

- Prania e infeksioneve seksualisht të transmetueshme (SST), HIV/AIDS, dhimbje pelvikale, trauma rektale ose vështirësi urinimi;
- Shtatzëni të padëshiruar për shkak të shfrytëzimit seksual, infertilitet, sëmundje inflamatore, shëndet i dobët riprodhues, aborte;
- Infeksione kronike ose gjymtim i shkaktuar nga proceduara jo-higjienike dhe të rrezikshme mjekësore.

Këta indikator nuk janë të vetmit. Çdo tregues i marrë individualisht nuk mund të nënkuptojë një situatë trafikimi dhe jo të gjitha viktimat e trafikimit me njerëz do të shfaqin këto shenja. Megjithatë, njohja e disa treguesve mund të tregojë nevojën për referime dhe vlerësim të mëtejshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Ministria e Shëndetësisë / Ministerstvo Zdravstva / Ministry of Health